



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Nr. 315 Prot.

Tiranë, më 14 Prill 2025

Drejtuar: Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS)
Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve

Nga: Znj. Erida Skëndaj
Drejtore Ekzekutive
Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Objekti: Ankim kundër vendimit nr. 481 datë 11.04.2025 të KSHZ për pushimin e hetimit administrativ për denoncimin nr. 52 me denoncues KSHH dhe të denoncuar Bashkia Durrës.

Baza Ligjore: Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë,
Konventa Europiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut,
Kodi Zgjedhor,
Vendimi nr. 9 datë 24.12.2020 i Komisionit Rregullator,
Vendimit datë 06.11.2020 për miratimin e Rregullores “Për funksionimin dhe zhvillimin e seancave të Komisionit të Sanksioneve dhe Ankimeve”.

Të nderuar anëtar të KAS,

Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH), në kuadër të realizimit të misionit të tij statutor për të kontribuar në zhvillimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, me mbështetjen e koordinatorëve lokalë, po monitoron në terren dhe në mënyrë proaktive, procesin parazgjedhor për zgjedhjet parlamentare të 11 Majit 2025 në 13 Bashki të Republikës së Shqipërisë.

Në kuadër të kësaj veprimtarie, nga ana e KSHH është paraqitur përpara KQZ denoncimi nr. 52 kundër Bashkisë Durrës për ushtrimin e një veprimtarie të ndaluar sipas nenit 91 të Kodit Zgjedhor dhe nenit 3 të Vendimit të KQZ nr. 9 datë 24.12.2020.

Me datë 11.04.2025 nga ana e KSHZ është vendosur pushimi i hetimit administrativ për këtë denoncim, pasi në opinionin e këtij institucioni nuk jemi para një veprimtarie të ndaluar.

Përpara se të ndalemi në analizimin e rrethanave në këndvështrim të ligjit, për të argumentuar vendimarrjen jo të drejtë të Komisionerit, po parashtrojmë rrethanat e rastit.

Konkretisht, në Bashkinë Durrës është evidentuar që me datë 03.02.2025 është shpallur një njoftim në faqen zyrtare të internetit të saj¹, nëpërmjet të cilit janë hapur aplikimet për projekte për promovimin e artit, kulturës, trashëgimisë dhe sportit, si dhe në vizionin për Durrësin si një qendër kulturore, turistike dhe sportive. Projektet që do të financohen pasi të përzgjidhen, kanë të bëjnë me:

- Koncerte, festivale dhe shfaqje artistike e sportive.
- Panaire dhe ose ekspozita që promovojnë artin, trashëgiminë dhe sportin.
- Organizimi i garave dhe turneve sportive me përfshirjen e komunitetit.

¹ <https://durrës.gov.al/2025/02/03/thirrje-per-projekt-propozime-ne-art-kulture-trashegimi-kulturore-dhe-sport-per-vitin-2025/>



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

- Projekte që përcjellin vlerat e trashëgimisë kulturore dhe sportive përmes artit dhe teknologjisë.
- Programet edukuese që përfshijnë artin, trashëgiminë dhe sportin, duke përdorur teknologjinë moderne.

Në këtë njoftim janë bashkëngjitur 6 dokumente të cilat shpjegojnë qëllimet dhe motivet e kësaj nisme, procedurën e aplikimit dhe dokumentet e nevojshme. (Dokumentet bashkëngjitur)

Sipas nenit 91 pika 4 të Kodit Zgjedhor dhe nenit 3 pika 3 të Vendimit të KQZ nr. 9 datë 24.12.2020 "Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve" parashikohet se: Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohej propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensione, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, etj., përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore.

Neni 91 pika 1 e Kodit Zgjedhor: "1. Institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve. Formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre."

Sipas nenit 3 pika 1.1 gërma "b" të Vendimit të KQZ nr. 9 datë 24.12.2020 "Për rregullat për raportimin e veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve" parashikohet se:

1.1 "veprimtari të ndaluara për tu promovuar" janë veprimtaritë publike sipas përkufizimit të nenit 2, të këtij vendimi, për të cilat janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion, apo janë transferuar fonde publike jo sipas planit buxhetor të miratuar, në periudhën 4 (katër) mujore para datës së zgjedhjeve dhe që përfshijnë:

b) mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve, kombëtare ose vendore, me karakter social dhe ekonomik, si edhe ato në funksion të mbrojtjes dhe ruajtjes së mjedisit, të shëndetit, të kulturës, rinisë, sporteve dhe të arsimit publik në të gjitha nivelet, si dhe të infrastrukturës, në shërbim të interesit publik;



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Së pari, në dritën e bazës ligjore të sipërcituar, një nismë e tillë e Bashkisë Durrës, e cila efektivisht i ka nisur pasojat juridike që nga dita e shpalljes në faqen zyrtare të Bashkisë² me datë 03.02.2025, hyn në fushën e veprimit të nenit 3 pika 1.1 e Vendimit nr. 9 datë 24.12.2020, dhe nenit 91 pika 1 dhe 4 e Kodit Zgjedhor. Arsyetimi i Komisionerit në pushimin e hetimit administrativ për denoncimin tonë nr. 52, qëndron në argumentin e pamjaftueshëm se vendimi dhe buxheti për financimin e promovimin e aktiviteteve kulturore, turistike e sportive janë miratuar para datës 11.02.2025.

Së dyti, Komisioneri ka interpretuar në mënyrë të ngushtuar dispozitat e Kodit Zgjedhor dhe Vendimit nr. 9 datë 24.12.2020, duke dalë në këtë mënyrë jashtë qëllimit që ligjvënësi ka pasur në normimin e veprimtarive të ndaluara. Qëllimi i parashikimit me ligj i veprimtarive të ndaluara për t'u ushtruar nga administrata qendrore dhe vendore, gjatë periudhës 4-mujore para zgjedhjeve, qëndron në garantimin e zgjedhjeve të lira, të ndershme dhe të barabarta siç detyron edhe Kushtetuta.³ Neni 91 i Kodit Zgjedhor parashikon se: ***"Katër muaj para datës së zgjedhjeve deri në formimin e qeverisë së re pas zgjedhjeve ndalohet propozimi, miratimi ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensione, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve, etj., përveçse kur nisma kushtëzohet nga gjendje të fatkeqësisë natyrore"***.

Në interpretim të normës së mësipërme, ***propozimi, miratimi, nxjerrja akteve ligjore ose nënligjore***, nënkupton marrjen e masave të tilla nga ana e organeve që janë subjekt i ndalimeve, për dhënien e përfitimeve, mbështetjes financiare etj. Fakti që Buxheti është miratuar para datës 11.01.2025 nuk është justifikues dhe i mjaftueshëm që një veprimtari publike të jetë në përputhje me kërkesat që parashikon neni 91 i Kodit Zgjedhor. Kjo për arsyen se, pavarësisht se buxheti është miratuar pa hyrë periudha 4-mujore e ndalimeve, nuk mund të themi të njëjtën gjë për nxjerrjen dhe zbatimin e aktit. Në kushtet, kur mbështetja financiare është publikuar, zbatohet dhe i sjell efektet e tij gjatë periudhës 4-mujore para zgjedhjeve, jemi para një veprimtarie të ndaluar, pasi qëllimi i ligjvënësit është të ndalojë ato veprimtari që financohen nga burime publike, të cilat në mënyrë të padrejtë dhe të paligjshme ndikojnë në vullnetin e zgjedhësve për të përcaktuar votën e tyre.

Veprimtari të ndaluara për t'u promovuar janë veprimtaritë publike për të cilat janë vënë rishtazi apo posaçërisht në dispozicion në periudhën 4-mujore para datës së zgjedhjeve dhe që përfshijnë mbështetjen dhe promovimin e projekteve dhe/ose të investimeve, kombëtare ose vendore, me karakter social dhe ekonomik, si edhe ato në funksion të mbrojtjes dhe ruajtjes së mjedisit, të shëndetit, të kulturës, rinisë, sporteve dhe të arsimit publik në të gjitha nivelet, si dhe të infrastrukturës, në shërbim të interesit publik.

Afati i aplikimeve në kuadër të thirrjes për projekt-propozime në art, kulturë, trashëgimi kulturore dhe sport për vitin 2025, niste me datë 03.02.2025 dhe përfundonte me datë 25.02.2025. Periudha e realizimit të projekteve do të jetë nga mars deri dhjetor 2025. Data

² <https://durres.gov.al/2025/02/03/thirrje-per-projekt-propozime-ne-art-kulture-trashegimi-kulturore-dhe-sport-per-vitin-2025/>

³ Neni 1 dhe 45 pika 4 e Kushtetutës.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

në të cilën niste ndalimi për ushtrimin e veprimtarive të ndaluara sipas Kodit Zgjedhor dhe Vendimit nr. 9 është data 11.01.2025 (4 muaj para datës 11.05.2025). Kjo thirrje është vënë në dispozicion të publikut pas datës 11.01.2025, duke përbërë një veprimtari të ndaluar.

Së treti, çmujmë se vendimarrja e Komisionerit nuk është në përputhje me nenin 6 të KEDNJ⁴, nenin 42⁵ dhe 142⁶ të Kushtetutës, të cilët parashikojnë detyrimin e një institucioni shtetëror, organi gjyqësor ose quasi – gjyqësor për të arsyetuar vendimet e tyre në kuadër të procesit të rregullt ligjor. Vendimi i dhënë nga KQZ nuk e përmbush standartin e një vendimi të arsyetuar dhe ezaurues në hetimin e të gjithë shkaqeve të denoncimit.

Denoncimi jonë ngrinte shqetësimin e nxjerrjes dhe publikimit të një thirrje për aplikim dhe financim të projekteve për aktivitete kulturore, turistike e sportive, duke ngritur dyshime të arsyeshme se një masë e tillë e marrë gjatë periudhës 4-muaj para datës së zgjedhjeve, synon ndërhyrjen në vullnetin e zgjedhësve për të përcaktuar votën e tyre.

Prandaj para Komisionerit përveç përcaktimit të faktit nëse ndodhemi para një veprimtarie të ndaluar apo jo, shtoheshin për zgjidhje edhe disa çështje:

1. Përcaktimi i saktë i momentit nga i cili konsiderohet se ky projekt për financim i ka sjellë efektet juridike, duke marrë për bazë edhe datën në të cilën është shpallur dhe periudhën në të cilën vendimi do të sjellë efektet juridike (kalimi i fondeve në llogari të përfituesve).
2. Interpretimi i saktë dhe i plotë i Kodit Zgjedhor dhe Vendimit nr. 9 datë 24.12.2020, duke synuar që të zbatohet korrektësisht qëllimi i ligjvënësist për ndalimin e atyre veprimtarive, të cilat ndikojnë dhe çënojnë lirinë, barazinë dhe ndershmërinë e zgjedhjeve. Jemi para faktit që një grant, fond, mbështetje financiare miratohet nga një organ i pushtetit vendor ose qëndror para periudhës 4 mujore të ndalimeve, por publikohet, nis të zbatohet dhe aplikohet gjatë periudhës 4- mujore para datës së zgjedhjeve. Në një situatë të tillë, ligji duhet të interpretohet në mënyrë të ngushtuar duke iu referuar datës së miratimit të projekt – vendimit, apo duke bërë një interpretim teleologjik i cili përfshin në analizë edhe datën e publikimit, hapjes së aplikimeve dhe zbatimit të tij?

Jurisprudenca e GJEDNJ është zhvilluar gjërësisht në lidhje me standartin e arsyetimit të vendimeve të dhëna nga institucionet shtetërore, organet gjyqësore ose quasi-gjyqësore.

Në çështjen Hirst kundër Mbretërisë së Bashkuar, Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut trajtoi çështjen në lidhje me vendimin e një institucioni dhe nëse vendimet e tij ishin në përputhje me të drejtën për një proces gjyqësor të drejtë sipas nenit 6 të KEDNJ. Ankuesi, Hirst, argumentoi se sistemi i Britanisë së Madhe për të lejuar të burgosurit të kundërshtojnë ndalimin

⁴ 1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij.

⁵ Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçrasteve kur parashikohet ndryshe në ligj për kundërvajtje të lehta penale, për çështje civile ose administrative me rëndësi ose vlerë të vogël, në përputhje me kushtet e parashikuara në nenin 17 të Kushtetutës.

⁶ 1. Vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara.



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

e tyre, veçanërisht vendimet për paraburgim, shkelte të drejtat e tij për një gjyq të drejtë. Çështja trajtoi posaçërisht nëse procesi i vendimarrjes i Bordit të Lirimit me Kusht, i cili përfshinte një shqyrtim dhe jo një gjyq të plotë, ishte në përputhje me nenin 6. Gjykata theksoi se neni 6 i Konventës zbatohet për institucionet kur ata ushtrojnë fuqi të ngjashme me ato të një gjykate, edhe pse nuk janë gjykata tradicionale. Ajo theksoi gjithashtu se një institucion quasi-gjyqësor duhet të sigurojnë që vendimet të jenë të arsyetuara në një mënyrë të mjaftueshme që palët të kuptojnë pse është marrë një vendim, ashtu siç kërkohet edhe për gjykatat.

Në çështjen Jablonski kundër Polonisë Gjykata shqyrtoi nëse vendimi një organi disiplinor (një institucion quasi-gjyqësor) në Poloni, i cili i vendosi një sanksion ndaj një avokati, përmbushte kërkesat e nenit 6. Ankuesi argumentoi se vendimi nuk ishte mjaft i arsyetuar dhe për këtë arsye shkelte të drejtat e tij sipas nenit 6. Gjykata e Drejtave të Njeriut arriti në përfundimin se arsyetimi i vendimit ishte i pamjaftueshëm, dhe ankuesi nuk ishte furnizuar me informacion të mjaftueshëm për arsye të vendimit për t'ia mundësuar atij ta kundërshtonte atë në mënyrë efikase. Po ashtu u konfirmua jurisprudenca se vendimet e organeve quasi-gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara, duke siguruar transparencë dhe drejtësi. Dështimi për të ofruar arsye të mjaftueshme mund të minojë të drejtën për një gjyq të drejtë.

Të dyja çështjet demonstrojnë se organet quasi-gjyqësore dhe institucionet shtetërore, edhe pse nuk janë gjykata tradicionale, duhet të sigurojnë arsyetim të plotë kur marrin vendime përkatëse. Kjo kërkesë është thelbësore për të siguruar që individët të kuptojnë arsyet e vendimeve që merren për ta dhe është një aspekt i të drejtës për një gjyq të drejtë sipas nenit 6.


Sa më sipër, KSHH çmon se vendimi i Komisionerit i cili pushon hetimin administrativ për denoncimin nr. 52, është marrë në interpretim dhe zbatim të gabuar të ligjit, nuk përmbush kërkesat e Kushtetutës, KEDNJ dhe Kodit të Procedurës Administrative për një proces të rregullt ligjor, duke e cënuar në këtë mënyrë garantimin e zgjedhjeve të drejta, të ndershme e të barabarta.

Ndodhur në këto kushte, mbështetur në nenin 91, 124/1, 144 të Kodit Zgjedhor, Vendimit nr. 9 datë 24.12.2020 dhe nenit 30 të Vendimit datë 06.11.2020 për miratimin e Rregullores "Për funksionimin dhe zhvillimin e seancave të Komisionit të Sanksioneve dhe Ankimeve", kërkojmë ndryshimin e vendimit të KSHZ nr. 482 datë 11.04.2025, duke vendosur pranimin e denoncimit nr. 52 dhe marrjen e masave sanksionuese ndaj të Bashkisë Durrës për ushtrimin e veprimtarive të ndaluara.

Me respekt,

Erida Skëndaj
Drejtore Ekzekutive





REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
TIRANË
ZYRA E REGJISTRIT TË OJF-VE

Tiranë, më 13.02.2025

VËRTETIM

Vërtetojmë se Shoqata "Forumi për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore" është regjistruar me urdhër të Ministrit të Drejtësisë nr. 17/1 datë 12.01.1991; me qëllim të vëzhgoje e të japë ndihmesën e vet në respektimin e mbrojtjen e të drejtave të njeriut e lirive themelore në vendin tonë, të sensibilizojë opinionin publik për këto çështje, ai ngre zërin dhe kërkon rivendosjen e të drejtave të shkelura të njeriut.

Me urdhërin nr 17/2 datë 13.05.1992 të Ministrit të Drejtësisë është miratuar ndryshimi i emrit të shoqatës nga "Forumi për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore" në "Komiteti Shqiptar i Helsinkit".

Me ndryshimin e ligjit për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse të gjitha dosjet e regjistruara pranë Ministrisë së Drejtësisë i kanë kaluar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, institucion i vetëm që ka të drejtën për regjistrimin; kryerjen e ndryshimeve përkatëse dhe mbajtjen e regjistrit përkatës në lidhje me organizatat jofitimprurëse. Në zbatim të këtij ligji aktet e themelimit të Komitetit Shqiptar të Helsinkit janë transferuar nga Ministria e Drejtësisë (momenti i regjistrimit fillestar) dhe janë depozituar pranë Zyrës së Organizatave Jofitimprurëse me numër 2, numër i cili i korrespondon momentit të ardhjes së kësaj dosje pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Me vendimin nr. 2/1 datë 19.07.2002 Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur pranimin e kërkesës për depozitimin e vendimit të datës 11.06.2002 të Mbledhjes së Përgjithshme të Zakonshme të Shoqatës "Komiteti Shqiptar i Helsinkit" në të cilin është vendosur : Miratimi i statutit të ri dhe nënshkrimi i tij nga anëtarët e Organizatës. Të depozitohet Statuti dhe aktet e shoqatës në përputhje me ligjin nr. 8788 datë 07.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse".

Me vendimin nr. 2/2 datë 24.03.2009 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi shqyrtoi kërkesën e kërkuarit Komiteti Shqiptar i Helsinkit me përfaqësues Vasilika Hysi, në cilësinë e Drejtores Ekzekutive, vendosi pranimin e kësaj kërkesë për depozitimin e vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme për disa ndryshime dhe shtesa në statutin e shoqatës. Në nenin 2.1. Shoqata ka si objekt shtohen pikat e mëposhtme : tu japë



keshillime ligjore shtetasve që pretendojnë se u janë cenuar liritë dhe të drejtat e tyre, të ofrojë opinione ligjore dhe ndihmë ligjore falas në raste të ndryshme të shkeljes të të drejtave të njeriut pranë Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe Gjykatave Shqiptare; Neni 3. Qendra dhe territori i veprimtarisë së shoqatës ndryshon si më poshtë: Qendra e shoqatës është në Tiranë Rr. Gjin Bue Shpata, pall.5/1, ap.4. Veprimtaria e saj do të shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë; Neni 8 ndryshon si më poshtë : Organi më i lartë drejtues i shoqatës është mbledhja e përgjithshme (KSHH) e anëtarëve të saj që përbëhet nga 11 deri në 15 persona, etj.

Me vendimin nr. 2/3, datë 30.12.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është vendosur depozitimi i vendimit datë 19 maj 2009 për miratimin e kërkesës për dorëheqjen e znj. Vasilika Hysi nga anëtarësia dhe pozicioni i Drejtores Ekzekutive. Vendimi i datës 7 tetor 2009 për emërimin e znj. Vjollca Meçaj, Drejtore e re Ekzekutive.

Me vendimin nr. 2/4, datë 06.05.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është vendosur depozitimi i vendimi nr. 06, datë 20.10.2011 "Për miratimin e ndryshimeve në Statutin e Komitetit Shqiptar të Helsinkit" të Asamblesë së Përgjithshme të Komitetit Shqiptar të Helsinkit, me të cilin është vendosur të miratohen ndryshimet si vijon: Lidhja C: Anëtarësia e Asamblesë së Përgjithshme, zotërinjtë Kristo Frashëri, Ylli Popa dhe Xhevahir Spahiu të cilët për shkak të gjëndjes moshore dhe shëndetësore, prej më se dy vjet nuk kanë mundur të frekuentojnë mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, bazuar në neni 5, pika 5.4/a dhe 5.6 të Statutit të KShH të përfshihen në kategorinë e "Anëtarëve të Nderit". Pranimin si anëtare të Asamblesë së përgjithshme të KShH zotërinjtë Dr. Sokol Sadushi, z. Artan Hoxha. Shkrimin e një pragrafi të ri në nenin 8 pika 8.1. Ndryshimin në lidhje me kompetencat vendimmarrëse të organeve të KShH: Ndryshimin e nenit 8.3, 10.1, 10.2, 10.3 të Statutit. Depozitimin e vendimit nr. 04, datë 08.10.2015 "Për disa ndryshime në organet drejtuese" të Asamblesë së Përgjithshme të komitetit Shqiptar të Helsinkit", me të cilin është vendosur që, në përbërje të Bordit Vendimmarrës të Organizatës të zgjedhë anëtarët e si vijon: Zana Sota, Sokol Sadushi, Elvis Koçi, Florian Ballhysa. Njëkohësisht, në këtë mbledhje Asambleja e Përgjithshme vendosi që, duke filluar nga 30 janar 2016, të pranojë si anëtare të Asamblesë znj. Vjollca Meçaj. Depozitimin e vendimit nr. 2, datë 04.02.2016 "Për pranimin e dorëheqjes së Drejtores Ekzekutive dhe termat e shkeputjes së mardhënieve financiare të saj me organizatën", të Asamblesë së Përgjithshme të Komitetit Shqiptar të Helsinkit, me të cilin është pranuar Kërkesa për dorëheqje nga pozicioni i Drejtores Ekzekutive të organizatës të znj. Vjollca Meçaj. Depozitimin e vendimit nr. 3, datë 24.02.2016 "Për emërimin e Drejtorit të ri ekzekutiv të KShH", të Asamblesë së Përgjithshme të Komitetit Shqiptar të Helsinkit, me të cilin është vendosur miratimi i emërimit të znj. Erida Skendaj, në pozicionin e Drejtores ekzekutive.



Me vendimin nr. 2/5, datë 22.06.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është vendosur depozitimi i Vendimit Nr.1 datë 27.04.2018 ka vendosur: Të pranojë pushimin e anëtarësisë bazuar në nenin 5.4 të Statutit të Komitetit Shqiptar të Helsinkit për këta anëtarë: Prof. Arben Puto (për shkak të ndarjes nga jeta), Prof. Jorgo Bullo (për shkak të ndarjes nga jeta), Z. Florian Ballhysa (sipas kërkesës së shkruar për dorëheqje bashkëlidhur këtij vendimi), Znj.Zana Sota (sipas komunikimit të realizuar me Drejtoresh Ekzekutive), Z. Artur Metani (sipas komunikimit të hershëm të realizuar me Z. Niazi Jaho). Me Vendimin Nr.2 datë 27.04.2018 ka vendosur: Të zgjedhë Presidentin e Asamblesë së KShH-së Znj. Vjollca Meçaj (me rotacion jo më shumë se 2 vjet). Me Vendimin Nr.4 datë 27.04.2018 të Mbledhjes së Përgjithshme të anëtarëve të Shoqatës Komiteti Shqiptar i Helsinkit” me anë të ka vendosur: bazuar në nenet 8.3 dhe 8.4 të Statutit të KShH-së, të pranojë në Asamblenë e Përgjithshme këta anëtarë të rinj: Luljeta Lleshanaku, Florian Hasko, Lutfi Dervishi, Fjoralba Caka, Julian Mërtiri.

Me vendimin nr. 2/6, datë 03.07.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është vendosur depozitimi i vendimit nr. 2 datë 15.Maj 2019 të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqatës Komiteti Shqiptar i Helsinkit, në të cilin është pranuar kërkesa e anëtarës Znj. Fjoralba Caka për heqjen dorë nga anëtarësia. Vendimin nr. 3 datë 15 Maj 2019 është pranuar kërkesa e Z. Fatmir Braka, për heqjen dorë nga anëtarësia. Me vendimin nr. 4 datë 15 Maj 2019 është pranuar kërkesa e Z. Flamur Çato, për heqjen dorë nga anëtarësia. Vendimi nr. 5 datë 15 Maj 2019 është vendosur ndryshimi i statutit si më poshtë vijon: “ Në pikën 8.3, pas germës “d”, shtohet germa “dh” si vijon: dh) Me propozim të Drejtorit Ekzekutiv miraton dhe ndryshon: - planet strategjike 3 vjecare të KSH H-së; Rregulloren e Brendshme të KSHH-së, Strukturën Organizative të KSHH-së; Nivelin e pagesave dhe kriteret për pagat e stafit të KSHH-së”. Në pikën 8.5 të statutit, fjalia e parë, hiqet togëfjalëshi “si dhe bordin këshillimor”. Në fjalinë e dytë të kësaj pike, togëfjalëshi “zgjedhja e tyre” ndryshohet në “zgjedhja e tij/e saj”. Neni 13.2 i Statutit shfuqizohet.

Me vendimin nr. 2/7, datë 01.12.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është vendosur Depozitimin e vendimeve dt 26.05.2022 të Asamblesë së Përgjithshme të shoqatës Komiteti Shqiptar i Helsinkit në të cilat është vendosur: Vendimi nr 2, dt 26.05.2022: Zgjedhjen nga gjiri i saj të Presidentit të Asamblesë së Komitetit Shqiptar të Helsinkit z.Kujtim Cashku. Vendimi nr 3, dt 26.05.2022 : Bazuar ne nenin 8.3 dhe 8.4 të statutit të shoqatës Komiteti Shqiptar i Helsinkit të pranojë në Asamblenë e Përgjithshme te anetarit te ri z. Arben Rakipi. Vendimi nr 4, dt 26.05.2022 : Të realizojë ndryshime në statutin e shoqatës Komiteti Shqiptar i Helsinkit. Vendimi nr 5, dt 26.05.2022 : Pranimin e kërkesës së z.Elvis Koci për pushimin e anëtarësisë, me efekt mbarimin e mandatit si anëtar i Asamblese se KSHH. Vendimi nr 6, dt 26.05.2022 : Ti jap votëbesimin për një mandat tjetër 6 vjeçar zj.Erida Skendaj, në pozicionin e Drejtores Ekzekutive të Komitetit Shqiptar të Helsinkit, për periudhën 26 maj 2022 – 25 maj 2028.

Me vendimin nr. 2/8, datë 07.04.2023 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është vendosur depozitimi i vendimit nr. 1, datë 20.12.2023 të Asamblesë së Përgjithshme të KSHH në të cilin është vendosur: pranimin në Asamblenë e përgjithshme të z. Klajdi Mone.

Me vendimin nr. 2/9, date 23.06.2023 të Gjykatës së Shkalles së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë është vendosur: depozitimin e vendimit nr. 1, date 25.04.2023 i Asamblese së Përgjithshme të KSHH "Per pranimin e kërkeses së znj. Luljeta Lleshanaku për pushimin e anetaresise për shka të perfundimit e mandatit si anetare e Asamblese së KSHH. Depozitimin e vendimit nr. 2, date 25.04.2023 i Asamblese së Përgjithshme të KSHH për pranimin si anetare në Asamblenë e Përgjithshme znj. Lea Ypi.


Me vendimin nr. 2/10, date 19.09.2023 të Gjykatës së Shkalles së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë është vendosur: Depozitimin e Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KShH) të Vendimit nr. 1, datë 25 Korrik 2023 "Per disa ndryshime në statutin e Komitetit Shqiptar të Helsinkit". Depozitimin e Vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Komitetit Shqiptar të Helsinkit (KShH) të Vendimit nr. 7, datë 25 Korrik 2023 "Per miratimin e pasqyrave financiare dhe raportit të auditit të përgjithshëm të organizatës për vitin 2022. Refuzimin e depozitimit në regjistrin e OJF-ve të Gjykatës së Shkalles së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë të Pasqyrave financiare të Komitetit Shqiptar të Helsinkit për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021, të audituara nëpërmjet Raportit të Auditit të lëshuar nga kompania audituese e pavarur Grant Thornton, të vërtetuar njësi me origjinalen përpara noterës.

Me vendimin nr. 2/11, date 27.09.2024 të Gjykatës së Shkalles së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë është vendosur: depozitimin e Vendimit nr. 1 datë 28.06.2024 Asambleja e Përgjithshme ka vendosur: Miratimin e Raportit të Auditimit për vitin 2023. Depozitimin e vendimit nr. 2 datë 28.06.2024 Asambleja e Përgjithshme ka vendosur: Rizgjedhjen e z. Kujtim Çashku si President të Shoqatës për një mandat 2-vjeçar. Depozitimin e vendimit nr. 3 datë 28.06.2024 Asambleja e Përgjithshme ka vendosur: Pranimin e kërkesës së z. Shaban Sinani për pushimin e anëtarësisë në Asamblenë e Komitetit Shqiptar të Helsinkit. Depozitimin e vendimit nr. 4 datë 28.06.2024 Asambleja e Përgjithshme ka vendosur: Miratimin e pasqyrave financiare të Komitetit Shqiptar të Helsinkit deri në datë 31.12.2023.

Ndryshime të mëtejshme nuk ka.

SEKRETARE E REGJISTRIT TË OJF-ve

Besa KORREPERISE



REPUBLIKA E SHQIPERISE

REPUBLIKA E SHQIPERISE

Skendaj

Erinda

Shqiptare/Albanian

Tirane, ALB

16-12-1983

11-04-2018

MPB

033628484

F

14-04-2028

1362108496

Erinda